

FJALA E DEPUTETIT NIKO PELESHI

E HËNË 5 DHJETOR 2022

Në fakt, nuk e mora fjalën për të replikuar për një procedurë, e cila mund të jetë e drejtë, por ka komisione që i vlerësojnë dhe, në mos gaboj, para 2-3 javësh ne kemi shpallur tetë dëshmorë nga zona e Selenicës. Patjetër që ky proces ka burokracitë e veta, por meriton seriozitet. Apeli dhe vërejtja juaj do të mbahen shënim nga ne dhe do të merrni një përgjigje, por, duke ju dëgjuar të flisnit, bëra një reflektim që shkon përtej ndasive komunist apo nacionalist, sepse, në fund të fundit, të gjithë ishin shqiptarë dhe luftuan për një çështje, e cila nesër do të vijë edhe si produkt i luftës dhe përpjekjeve të tyre.

Pra, luftuan për Shqipërinë në krahun e vendeve të lira, në krahun e lirisë, në krahun e përparimit, në krahun e Europës. M'u kujtua kur 80 vjet më parë, një idealist shqiptar i quajtur Llazar Fundo ose Zai Fundo, siç njihet, i cili, gjithashtu, nuk ka pasur një fund të mirë, por le të shikojmë përtej kësaj, i internuar në Ventotene, së bashku me Altiero Spinellin, shkruan manifestin e famshëm të Ventotenes, që ishte një prelude për Bashkimin European, madje shkonte edhe përtej asaj që ka ndodhur sot, kur është një realitet projekti i Bashkimit European, fliste për Europën federale.

Kështu që, duke i marrë të gjitha këto ngjarje, të cilat i prekët edhe ju, pra, Luftën Çlirimtare, pasaportën europiane që Shqipëria e fitoi edhe për shkak të kësaj lufte, por edhe për shkak të pozicionimit të vet në shumë ngjarje historike gjatë shekujve të fundit, të drejtën për të kërkuar vendin e vet në projektin e Europës së bashkuar, si dhe duke sjellë në këtë parlament ngjarjen e nesërme, natyrisht që emocionohemi të gjithë dhe ia vlen të gëzohemi dhe ta celebroidim atë ditë, të pabesueshme deri para pak kohësh. Unë jam një prej studentëve të dhjetorit dhe akoma më kumbojnë në vesh thirrjet "E duam Shqipërinë si gjithë Europa". Nesër e gjithë Europa do të vijë në Shqipëri.

Destinacioni ynë i vetëm historik i Shqipërisë dhe i Ballkanit Perëndimor është Bashkimi European. Kjo është aspirata jonë frymëzuese dhe shpresëdhënëse, e cila është përgjigja më e mirë edhe për fenomene të kohës, nga të cilat duhet të shërohemi të gjithë, të gjitha vendet e Ballkanit, të gjitha vendet më pak të zhvilluara sesa Europa Veriore dhe që sjellin, natyrisht, edhe migrim apo largime të të rinjve drejt një vendi më të mirë apo drejt vendeve me më shumë shanse. Pra, nëse flasim për këto lloj

fenomenesh, sesi të rinjtë tanë të qëndrojnë këtu, sesi ta projektojnë të ardhmen këtu e të tjera, e vetmja përgjigje është Bashkimi European dhe t'i shërbejmë kësaj ëndrre.

Pra, jo vetëm ta mirëpresim, por edhe të punojmë çdo ditë për ëndrrën tonë europiane, sepse rruga drejt Bashkimit European është shpresëdhënëse, është mirëqenie, është zhvillim ekonomik, por tani është edhe siguri. Projektet e Bashkimit European në kuadër të Procesit të Berlinit, edhe para se të bëhemi anëtarë, apo të Ballkanit të Hapur si pjesë dhe si derivat i këtij procesi, janë projekte zhvilluese, të cilat i japin vendit tonë pozicionin që i takon në rajon, por edhe siguri në një botë ku paqja dhe siguria janë tronditur.

Pra, ato pasazhe historike, që ju i sillni herë pas here në këtë parlament dhe unë ju falënderoj për ndjenjat tuaja nacionaliste (e them pa bërë aspak ironi), janë një arsye më tepër pse ne duhet të jemi nesër të gjithë bashkë dhe pse ata që kanë vendosur t'i qëndrojnë kundër atij samiti, duhet të ndihen të turpëruar. Unë jam i bindur që ju nuk do të jeni një prej tyre, sepse ju jeni nationalist, ju e doni Shqipërinë, ju e doni Shqipërinë europiane, ju e doni Shqipërinë në Europë. Le të gëzohemi nesër së bashku, por nga nesër le të bashkojmë forcat për projektin european dhe le të ndahemi pastaj në çështjet e tjera të ditës. Europa është toka jonë e përbashkët dhe destinacioni ynë i vetëm historik, që nuk mund të na ndajë, turp për ata që do t'i qëndrojnë përballë nesër! Faleminderit!